

KOMUNA DIBËR
SHPALLJE NUMËR 10-224/1-2025
PËR TJETËRSIM TË TOKËS NDËRTIMORE PRONË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NËPËRMJET ANKANDIT
ELEKTRONIK PUBLIK PËR OBJEKTE ME DESTINIM

1. B - DESTINIME KOMERCIALE DHE AFARISTE (B1 - DESTINIME TË VOGLA KOMERCIALE DHE AFARISTE, B2 - NJËSI TË MËDHA TREGTARE, B3 - NJËSI TË MËDHA HOTELEERIKE, B4 - HAPËSIRA AFARISTE, B5 - KOMPLEKSE HOTELEERIKE DHE B6 - NDËRTESA PËR TUBIME)

Në përputhje me Planin e detajuar urbanistik të bllokut urban - 25 zona me destinim të veçantë Kazerma - „Liman Kaba,, miratuar me vendimin nr.07-218/5 data 09.03.2010 .

2. A1-banime në ndërtesa banimi (me klasa qëllimi të përputhshme – B1 -max.40%.

Sipas Planit të Detal Urbanistik për një pjesë të Bllokut 12 (me periudhë planifikuese 2022-2027) Vendimi nr. 08-859/11, me datë 16.08.2023, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunës së Dibrës nr. 28/ 2023.

LËNDË E ANKANDIT ELEKTRONIK PUBLIK

Lëndë e ankandit elektronik publik është toka e pandërtuar në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e paraparë me:

1. Planin e detajuar urbanistik të bllokut urban - 25 zona me destinim të veçantë Kazerma - „Liman Kaba,, miratuar me vendimin nr.07-218/5 data 09.03.2010, me destinim të ndërtimit të destinimeve komerciale dhe të biznesit me karakteristikat në përputhje me tabelën nr. 1.

TABELA nr.1

Nr. i PN dhe destinimi	Nr. i PK të gjitha KK DIBËR-3	Lartës. Max. deri te kurora (m)	Sf. e PN (m^2)	Sipërf.. për ndërtim (m^2)	Përqi-ndja e ndërtimit (%)	Koef. i shfry-tëzimit	Çmimi fillestar në (m^2) (denarë)	Çmimi fillestar i përgjithshëm (denarë)	Garanci bankare për seriozitetin e ofertës (denarë)
1 25.3 B	9208/8	8.50	4354	2610	60	1.0	1.100,00	4.789.400,00	9.578.800,00
2 25.14 B	9208/5	8.50	4091	2455	60	1.0	1.100,00	4.500.100,00	9.000.200,00
3 25.15 B	9208/3	8.50	3257	1952	60	1.0	1.100,00	3.582.700,00	7.165.400,00

1. Plani Detal Urbanistik për pjesën e Bllokut 12 (me periudhë planifikuese 2022-2027) Vendim nr. 08-859/11, me datë 16.08.2023, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunës së Dibrës nr. 28/ 2023. ., me qëllim ndërtimin e banesave A1 në objektet e banimit me karakteristika në përputhje me tabelën nr. 2.

TABELA nr.2

Nr. i PN dhe destinimi	Nr. i PK të gjitha KK DIBËR-1	Lartës. Max. deri te kurora (m)	Sf. e PN (m^2)	Sipërf.. për ndërtim (m^2)	Përqi-ndja e ndërtimit (%)	Koef. i shfry-tëzimit	Çmimi fillestar në (m^2) (denarë)	Çmimi fillestar i përgjithshëm (denarë)	Garanci bankare për seriozitetin e ofertës (denarë)
1 12.03 A1	5546/10	8.50	552	155	28,01	0,84	61,00	33.672 00	67.344,00
2 12.01 A1	5546/11	8.50	554	165	29,80	0,89	61,00	33.794 00	67.588,00
3 12.02 A1	5546/12	8.50	552	165	29,90	0,90	6100	33.672 00	67.344,00
4 12.08 A1	5546/13	8.50	552	165	29,90	0,90	61,00	33.672 00	67.344,00

E DREJTA NË PJESEMARRJE

Të drejtë për të marrë pjesë në ankandin publik kanë: Të personat të interesuar vendor dhe të huaj fizik dhe juridik të cilët mund të fitojnë pronësi në tokë ndërtimore në territorin të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me ligjin dhe i plotësojnë kushtet të dhëna në shpallje dhe atë :

1. Personat fizik: qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe shtetas të vendeve që nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian dhe të OECD, por nën kushtet e reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën të pronës të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë .

2. Personat juridik: person juridik i vendit, person juridik në pronësi të përbashkët, person juridik i themeluar nga person i huaj fizik dhe person juridik i regjistruar në Regjistrin Qëndror të RMV-së, persona juridike të huaj rezidentë në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe të personat të huaj juridikë rezidentë në vendet që nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian dhe të OECD, të cilat nën kushtet e reciprocitetit mund të fitojë të drejtën e pronës të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut .

KUSHTET PËR PJESEMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK.

Personat fizikë dhe juridikë të interesuar paraqesin parashtrimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik nëpërmjet sistemit informativ të vendosur në faqen e internetit www.gradezno-zemjiste.mk , me plotësimin të formularit elektronik të cilin e nënshkruan me certifikatë të vlefshme digjitale të lëshuar nga personi i autorizuar për ç'do parcelë ndërtimore veç e veç, ku është deklaruar se për cilën parcelë ka të bëjë vetë parashtrësja dhe cilët dokumente janë pjesë e parashtrimit të kompletuara me dëshmitë në vijim , të parashtruara në formë elektronike, ku dokumentacioni i nevojshëm bashkanjgjetet si kopie e skenuar në PDF ose fotografi në jpg ose jpeg formë, në të cilën theksohet se për cilën parcelë parashtrësja konkrete dhe cilat dokumenta janë pjesë përbërëse e parashtrësës, të kompletuara me dëshmitë në vijim (të parashtruara në original ose fotokopje të noterizuara) .

1. Kërkesa e aplikantit, ku janë deklaruar të dhënat për parashtruesin e fletëparaqitjes, të dhënat për cilën parcelë ndërtimore ka të bëjë fletëparaqitja dhe cili dokumentacionin dorëzohet bashkanjgjetur me paraqitjen e nënshkruar në mënyrë digjitale . Nëse personi i cili e plotëson parashtrësën për ankand është në rol të personit të autorizuar e detyrueshme është të bashkanjgjisë autorizim të noterizuar ;

2. Garancion bankar për seriozitetin të ofertës e cila është verifikuar në pajtim me pasqyrën tabelare e dhënë në këtë shpallje, ofertë me vlerë 200% nga vlera fillestare e përgjithshme e tokës ndërtimore me afat vlefshmërie deri në datë 31.07.2025 , me të cilën garantohej se nëse mer status të ofertuesit më të volitshëm do të paguajë vlerën më të lartë të aritur për tjetërsim të tokës ndërtimore në ankandin elektronik publik në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm (të vendoset nr. i shpalljes dhe numri i parcelës ndërtimore në qëllimin e garancionit) ;

3. Për personat fizik, certifikatën e shtetësisë;

4. Për subjektet juridike, vërtetim për regjistrim të personit juridik në regjistrin përkatës;

5. Prokurë autorizimi për përfaqësuesin që përfaqëson personin juridik, apo dëshmi që tregon personin e autorizuar përgjegjës i personit juridik;

2.Garancia bankare do t'u kthehet aplikantëve që nuk kanë arritur ofertën më të favorshme, brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit publik.

3. Garancia bankare për seriozitetin e ofertës në ankand publik i kthehet ofertuesit më të favorshëm, e reduktuar për 10% të vlerës së garancisë bankare, por jo më shumë se 15.000 denarë, e caktuar për shpenzime të veçanta të procedurës së tjetërsimit me ankand publik, brenda 15 ditëve nga data e pagesës së shumës totale të arritur në ankandin publik për tjetërsimin e tokës ndërtimore dhe dorëzimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar për pjesëmarrje në ankand publik.

6. E-mail adresën e dorëzuesit të parashtrësës, përmes të cilit do të kryet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, dhe do ti dërgohet emri shfrytëzues dhe fjalëkalimi për të hyrë në faqen e internetit në të cilën do të zhvillohet ankandi publik elektronik, (për aplikantët të cilët paraqesin një adresë e-mail të gabuar, komuna Dibër nuk ka detyrim për të marrë dhe të bëjë korrigjime në të).

7. Deklaratë për pranimin e kushteve në shpallje e nënshkruar me nënshkrim digjital ;

Komisioni pas skadimit të afatit për aplikim të paraqitjeve , vërteton nëse aplikimet janë të kompletuara dhe të parashtruara në pajtim me kushtet e shpalljes.

Nëse merret pjesë në ankandin publik elektronik në më shumë se një parcelë ndërtimore, mjaftueshëm është që në original ose kopje të vërtetuar nga noteri të paraqesë dokumentet e përmendura më lart në vijim të një aplikimi, dhe në tjerat mund të paraqesë fotokopje.

Komisioni i njofton parashtruesit të aplikimeve për kompletueshmërinë të të njejtave në mënyrë elektronike në afat prej 24 orëve pas skadimit të afatit për dorëzimin e tyre, me ç'rast parashtruesve të aplikimeve të cilët kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju jep emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimi për pjesëmarrje në ankandin publik, kurse parashtruesit të aplikimeve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar u dorëzon njoftim me arsyetim se të njejtat nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar i tenderit publik elektronik për parcelat ndërtimore të shënuara në tabelën nr. 1 është 1.100,00 denarë për metër katror për PN nr. 25.3; PN nr. 25.14 dhe PN nr. 25.15, ndërsa çmimi fillestar i tenderit publik elektronik për parcelat ndërtimore të shënuara në pasqyrën tabelare nr. 2 është 61,00 denarë për metër katror për PN nr. 12.01; PN Nr. 12.02; PN Nr. 12.03 dhe PN Nr. 12.08

GARANIONI BANKAR

1. Garancioni bankar për seriozitetin e ofertës për çdo parcelë ndërtimore është përcaktuar në pasqyrën tabelare të dhënë në këtë shpallje dhe është 200% nga vlera fillestare për çdo parcelë ndërtimore në veçanti.

AFATET

Aplikimet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të parashtrohen nga data 02.05.2025 deri me datën 01.06.2025 (30ditë), në mënyrë elektronike, nëpërmjet sistemit informativ në faqen e internetit www.gradezno-zemjiste.mk.

Ankandi publik do të bëhet në formë elektronike në faqen vijuese të internetit www.gradezno-zemjiste.mk

Ankandi publik do të fillojë në;

Me datë 04.06.2025, dhe kjo do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjet) minuta si më poshtë;

Në orën 09:00 me zgjatje prej 15 (pesëmbëdhjet) minuta për PN me numër 25.3,

Në orën 10:00 me zgjatje prej 15 (pesëmbëdhjet) minuta për PN me numër 25,14.

Në orën 11:00 me zgjatje prej 15 (pesëmbëdhjet) minuta për PN me numër 25,15.

Me datë 04.06.2025, i njëjti do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) minuta si më poshtë;

Në orën 12:00 me kohëzgjatje 15 (pesëmbëdhjetë) minuta për PN numër 12.01.

Në orën 13:00 me kohëzgjatje 15 (pesëmbëdhjetë) minuta për PN numër 12.02.

Në orën 14:00 me kohëzgjatje 15 (pesëmbëdhjetë) minuta për PN me numër 12.03.

Në orën 15:00 me kohëzgjatje 15 (pesëmbëdhjetë) minuta për PN me numër 12.08.

PROCEDURA

1. Komisioni i njofton parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të njëjtave në formë elektronike, në afat prej 24 orëve pas skadimit të afatit për dorëzimin e tyre, me ç'rast parashtruesve të fletëparaqitjeve që kanë dërguar dokumentacion të kompletuar ua dërgon edhe emrin shfrytëzues edhe fjalëkalimin për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë dërguar dokumentacion të kompletuar u dërgon njoftim me arsyetim se të njëjtit nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

2. Në ditën e ankandit publik elektronik, pjesëmarrësit hyjnë në faqen e internetit me një emër përdoruesi dhe fjalëkalim që kanë marrë në adresën e postës elektronike, të paraqitur krahas aplikimit për pjesëmarrje në ankand publik.

3. Pjesëmarrës në ankand publik janë aplikantët që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë dhe kanë marrë emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për pjesëmarrje në ankand publik. Ankandi publik elektronik do të mbahet nëse pas shpalljes ka aplikuar dhe ka ofruar çmimin fillestar vetëm një pjesëmarrës që plotëson kushtet e përcaktuara në njoftim.

4. Ankandin elektronik publik e ndjek Komisioni, i formuar nga kryetari i Komunës Dibër.

5. Ankandi elektronik publik fillon me publikimin e çmimit fillestar të tokës që është lëndë e paraqitjes për metër katror, e zbatohet nëpërmjet ankandit nga ana e pjesëmarrësve në ankand.

6. Ankandi zhvillohet në mënyrë 'hap pas hapi', me rritje të vlerës në çdo hap, ku secili hap përbën jo më pak se 10% të çmimit minimal fillestar për metër katror për shitjen e tokës ndërtimore, përkatësisht vlera e çdo 'hapi' është së paku 110,00 denarë për parcelat ndërtimore të përmendura në Tabelën nr. 1.

7. Ankandi kryhet "me hapa" me rritje të shumës të çdo "hapi" jo më pak se 10% të çmimit fillestar minimal për metër katror për tjetërsimin e tokës ndërtimore, gjegjësisht shuma e secilit "hap" është së paku 10,00 denarë për parcelat ndërtimore të shënuara në tabelën nr. 2.

8. Ankandi publik elektronik konsiderohet i përfunduar në momentin e skadimit të kohës së përcaktuar në shpallje. Nëse gjatë dy minutave të fundit bëhet një ofertë nga ndonjë pjesëmarrës, afati për përfundimin e ankandit zgjatet për edhe dy minuta. Ankandi vazhdon pa kufizim derisa brenda një intervali kohor prej dy minutash të mos bëhet asnjë ofertë e re.

9. Pjesëmarrësi në ankandin publik që ka ofruar çmimin më të lartë fiton statusin e ofertuesit më të volitshëm.

10. Ofertuesi më i favorshëm për metër katror konsiderohet pjesëmarrësi në ankand publik që ka ofruar çmimin e fundit për metër katror, i cili përfaqëson çmimin më të lartë për tjetërsimin e tokës ndërtimore.

11. Pas përfundimit të ankandit publik, Komisioni për Zbatimin e Procedurave të Ankandit Publik përgatit procesverbal për ankandin publik të zhvilluar dhe ia dërgon atë në mënyrë elektronike të gjithë pjesëmarrësve në ankand publik.

12. Pjesëmarrësit kanë të drejtë të kundërshtojnë zhvillimin e ankandit publik brenda tre ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik. Ankesa i paraqitet me shkrim komisionit, i cili me vendim vendos për ankesën. Komisioni është i obliguar të vendosë për ankesën brenda pesë ditëve të punës. Kundër vendimit të Komisionit, i cili vendos për ankesën e paraqitur, pala ka të drejtë të ankohet në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurat Administrative, Procedurat e Punës dhe Mbikëqyrjen Inspektuese në shkallë të dytë në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit të vendimit. Procedura e tenderit publik përfundon pas kalimit të tre ditëve nga dita e tenderit publik, nëse nuk është paraqitur kundërshtim. Procedura e tenderit publik përfundon me vendim të Komisionit për Zbatimin e Procedurave të Tenderit Publik nëse kundër vendimit nuk është paraqitur ankesë dhe nëse është paraqitur ankesë, procedura e tenderit publik konsiderohet e përfunduar me marrjen e vendimit ligjërish të detyrueshëm.

13. Pas përfundimit të procedurës së tenderit publik, Komisioni është i obliguar që në afat prej tri ditësh të punës t'i paraqesë kërkesë për mendim Avokatit të Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me tekstin e marrëveshjes për tjetërsimin ose dhënien me qira afatgjatë të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

14. Avokatura shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e obliguar që në afat prej 30 ditësh nga pranimi i kërkesës për mendim të paraqesë mendim lidhur me draft tekstin e marrëveshjes për tjetërsimin ose qiradhënien afatgjatë të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nëse Avokatura Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk paraqet mendim në afat prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet pozitiv.

15. Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Avokatura shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni në afat prej tri ditësh do t'i dërgojë njoftim për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm.

16. Ofertuesi më i volitshëm, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për përzgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm, është i detyruar të paguajë mjetet dhe t'i dorëzojë Komisionit vërtetimin e pagesës. Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk i paguan mjetet brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se toka ndërtimore nuk është tjetërsuar, nuk do të lidhet marrëveshje tjetërsimi dhe do të aktivizohet garancia bankare për seriozitetin e ofertës dhe ofertuesi nuk do të mund të marrë pjesë në asnjë ankand publik të ardhshëm për parcelën ndërtimore në fjalë.

17. Nëse ofertuesi më i volitshëm paguan mjetet dhe në bazë të dokumentacionit të paraqitur nuk mund të lidhet kontratë, mjetet nuk kthehen, do të aktivizohet garancia bankare për seriozitetin e ofertës dhe nuk do të lidhet asnjë kontratë.

18. Kryetari i Komunës së Dibrës, në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat prej 5 (pesë) ditësh pune pas dorëzimit të vërtetimit të pagesës dhe dorëzimit të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për pjesëmarrje në ankand publik, lidh marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

19. Pas lidhjes së marrëveshjes, Komuna e Dibrës në afat prej 1 (një) dite dorëzon në mënyrë elektronike marrëveshjen në Sektorin për Çështje Financiare - Departamenti për Administrim dhe Inkasimin e të Hyrave Vendore për përcaktimin e tatimit në shitje të patundshmërive. Blerësi është i detyruar që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e vendimit për përcaktimin e taksës së shitjes së pasurisë së paluajtshme, të paguajë tatimin dhe të paraqesë vërtetimin e pagesës së kryer.

20. Pas dorëzimit të dëshmisë së pagesës së taksës së pasurisë së paluajtshme, blerësi, brenda 30 ditëve, dorëzon në mënyrë elektronike kontratën tek noteri për solemnizim. Blerësi, përkatësisht qiramarrësi, është i detyruar të kryejë solemnizimin brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të kontratës tek noteri kompetent.

21. Mospërbushja e detyrimeve sipas kontratës për faj të blerësit përbën shkak për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, ku blerësit nuk i kthehet 80% e shumës totale të tjetërsimit. Shkëputja e kontratës për shkak të mospërbushjes së obligimeve në kontratë nga blerësi bëhet me deklaratë të njëanshme të vullnetit të tjetërsuesit të shprehur nga Komuna e Dibrës përmes Avokaturës Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

22. Me kontratë, ofertuesi (blerësi) më i volitshëm është i detyruar të marrë miratimin për ndërtimin e objektit të planifikuar në përputhje me planin urbanistik sipas të cilit toka është tjetërsuar në afat prej 9 (nëntë) muajsh nga solemnizimi i kontratës dhe është i detyruar ta ndërtojë objektin në përputhje me planin urbanistik sipas të cilit toka është tjetërsuar në përputhje me dispozitën e ligjit për ndërtim, dhe sipas kategorizimit të objektit. Në rast të kundërt, nëse blerësi nuk merr miratimin brenda afatit të caktuar, pra nëse objekti nuk ndërtohet brenda afatit të caktuar për faj të blerësit, blerësi do të detyrohet të paguajë një gjobë kontraktuale në masën 1,5% të çmimit total të arritur në ankand publik për tokën në fjalë për çdo muaj që ka kaluar afati i parë, pra 3% e çmimit total të arritur të ankandit publik të trullit subjekt për çdo muaj të kaluar në vitin e dytë nga skadimi i afatit, pra 4,5% e çmimit total të arritur të ankandit publik të tokës lëndore për çdo muaj të kaluar në vitin e tretë dhe çdo vit pasardhës nga skadimi i afatit.

23. Mospërbushja e këtyre detyrimeve, pra pasi blerësi bie në vonesë në përbushjen e këtyre detyrimeve për tre muaj radhazi, përbën bazën që tjetërsuesi, pas tre thirrjeve mujore të njëpasnjëshme për ekzekutim, si kreditor me deklaratë mospërbushje të detyrimeve të kontratës, të kërkojë konfirmimin e ekzekutimit të kontratës, pra të kërkojë pagesën e gjobës kontraktuale, e cila është edhe bazë për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, ku blerësit nuk i kthehet 80% e shumës totale të tjetërsimit. Shkëputja e kontratës për shkak të mospërbushjes së obligimeve në kontratë nga blerësi bëhet me deklaratë të njëanshme të vullnetit të tjetërsuesit të shprehur nga Komuna e Dibrës përmes Avokatit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

24. Përqindja minimale që duhet të ndërtohet nga totali i sipërfaqes së ndërtimit të zhvilluar të parashikuar me plan urbanistik për parcelën ndërtimore në fjalë nuk duhet të jetë më e vogël se 30 (tridhjetë) % përqind.

25. Ofertuesi më i volitshëm (blerësi) merr përsipër të paguajë taksën e shitjes që do të lindë si detyrim pas kontratës së lidhur për tjetërsimin e tokës ndërtimore.

26. Në çmimin e tokës ndërtimore nuk është e përfshirë tarifa për zhvillimin e tokës ndërtimore.

27. Shpenzimet e solemnizimit të kontratës pranë noterit kompetent dhe shpenzimet e regjistrimit në librat publikë të të drejtave të pasurive të paluajtshme që mbahen pranë Agjencisë së Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme përballohen nga blerësi i tokës ndërtimore, si dhe shpenzimet noteriale në rast të ndërprerjes së kontratës për faj të blerësit.

28. Pronari i tokës ndërtimore të fituar në procedurë të tjetërsimit me ankand publik nuk mund ta kalojë atë te të tretët para përmbushjes së detyrimeve nga kontrata për tjetërsimin e saj. Ndalimi i kalimit te të tretët shënohet në librin publik të regjistrimit të të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme.

29. Toka ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila është objekt i shpalljes, nuk mund të jetë pjesë e pasurisë së falimentimit derisa të përmbushen detyrimet nga kontrata.

30. Shpenzime të veçanta në procedurën e tjetërsimit dhe dhënies me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut me tender publik janë:

- shpenzimet për sigurimin e dëshmive për tokën ndërtimore objekt i tenderit publik;
- shpenzimet për publikimin në media dhe organet publike;
- shpenzimet për kqyrjen në terren dhe konstatimin e gjendjes faktike dhe për marrjen në posedim të tokës ndërtimore.

Shuma e shpenzimeve është 10% e vlerës së garancisë bankare për seriozitetin e ofertës, por jo më shumë se 15.000,00 denarë.

Ky njoftim do të publikohet edhe në faqen e Komunës së Dibrës. www.dibra.gov.mk

KOMUNA DIBËR
Komisioni për zbatim të
procedurave të ankandit publik

10-224/1 me datë 23.04.2025 .